



749
05.7.2024
REPUBLICA E SHQIPËRISË



3

№ 3072/1 Prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Elbasan më 5 /07/2024

VENDIM

Nr 60 datë 3 /07/2024.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MAJ 2024

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin MAJ 2024, 60 familje me fond 167.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Përgj Kujdesit Social
Drejtori Juridik

D.Rroseni
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

3071/2
8.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 749/1 Prot

Elbasan, më 8.7.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektine e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.60, datë 03.07.2024 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2024", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Ali MYSLIU



450
05.07.2024
REPUBLICA E SHQIPËRISË
SHKRETIJA
E DEKRETEVE DHE
LEJENAVE
DREKTORIA E QARKUT



311

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 307/1 Prot

Elbasan më 5 / 07 / 2024

VENDIM

Nr. 61 datë 3 / 07 / 2024

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin MAJ 2024

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **MAJ 2024** gjithsej 219 familje me një fond prej 957.481 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social
Drejtori Juridik

D.Roseni
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elvi Cuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

3072/2

8.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 750/1 Prot

Elbasan, më 8.7.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.61, datë 03.07.2024 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Maj 2024", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI
AB MYSLIU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3073/1 Prot

Dt. 05.07.2024.

VENDIM

Nr. 62 Datë 03/07/2024

Për një ndryshim në VKB Nr. 29. Dt. 28.03.2024 "Për një ndryshim në VKB nr.6 dt 26.01.2024 për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, të ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 3/07/2024

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e targave dhe të nomativave të konsumit të karburantit për mjetet sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë të gjitha masat për kontrollin dhe evidencimin e të gjitha lëvizjeve dhe orëve të punës të automjetit, me qëllim mirëmenaxhimin e konsumit të karburantit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
3. Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për përballimin me fonde të buxhetit vendor të njësisë shpenzuese, të gjitha shpenzimeve për karburant, pjesë këmbimi dhe të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera ligjore (kolaudim, sigurim, etj) për përdorimin normal të mjeteve motorrike, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
4. Ngarkohet Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konceptoi:

Drilona Mema

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Elvi Cuni



Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 361 Prot

Dt. 19.06 2024

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296.datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit.

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin Nr 11 datë 09/01/2024

Anetarët e komisionit:

- Gazmend Gaxhja
- Kastriot Zeneli
- Drilona Mema

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

1. Automjeti tip Fuoristrade Benz me targë AB968OC për 100 km të përshkruar harxhon 14 Litra Gazoil DI.

Në përcaktimin e normativave u mbajtën parasysh normativat egzistuese. disa tregues të rëndësishëm sic janë viti i prodhimit ,tipi e lloji i mjetit, amortizimi i tij, gjendja reale teknike e mjetit, rrugët që do të përshkohen, ndalesa në semafore, trafiku në qytet, natyra e punës për makinerinë e rënde, nevojat e përdorimit të funksioneve shtesë etj.

Këto normativa do të zbatohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

KOMISION

Gazmend Gaxhja

Kastriot Zeneli

Drilona Mema

DREJTOR I PËRGJITHSHEM

Altin Cenolli



Adresa: (Lagje "Shkumbini," , Rruga "Shkumbini," (pranë rrugës nacionale Elbasan – Gjinar km1- TEL: +355 58523312)

KERKESE

Dt 16.04.2024

SUBJEKTI: Ndryshim targe

Une I nenshkuari Resul Hoxha me detyre administrator ne njesine administrative Gjergjan per arsye te zevendesimit te automjetit tip BMW me targe AB 445 DF me automjetin tip Benz me targe AB 446 IO Kerkoj nga ana juaj te behen sistemimet perkatese.

Ju falenderoj per mirekuptimin tuaj,

ADMINISTRATORI




Kerkese

**Drejtuar: AGJENCISE SE SHERBIMEVE RURALE (ARSH)
BASHKIA ELBASAN**

Unë Jonuz Qosja me Nr personal G01008011R me pozicion Administrator i Njesisë Administrative Labinot Fushë ne Bashkine Elbasan kam ne përdorim nje automjet t tipit Mercedes Benz/204 vitit 2007 me targa AB 029 ER qe e perdor gjate punes , Kerkoj nga institucioni juaj qe te me kompesoj tollonat e naftes sipas sasise qe shpenzoj gjate detyres time si administrator sipas ligjit perkates per kompensimin e sasise se naftes .

Administratori

Jonuz Qosja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
NJESIA ADMINISTRATIVE GJINAR

Gjinar, më 08.04.2024

KËRKESË


Lënda :“Për ndryshim targë nga AA668YD në AB489NC”

Unë Emanuel Hida me detyrë Administrator ne Njësën Administrative Gjinar ,për arsye të heqjes nga pronsia të automjetit Volkswagen golf me targ AA668YD dhe blerje të automjetit Hyndai santa fe me targ AB489NC, kërkoj që të ndryshohet dhe në listat e Agjencis e Sherbimeve Publike targa e vjeter me targen e re .

Duke ju falenderuar në mirëkuptimin tuaj.

Administratori

Emanuel HIDA



LISTA MAKINERIVE SIPAS INSTITUCIONEVE TE BASHKISE

ADMINISTRATA

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	KARBURANTI
1	AA 576 DF	Volkswagen	9 Litra/100 km Ne muaj 400Litra	Gazoil D 1
2	AA 101 DC	Volkswagen	9 Litra/100 km Ne muaj 250 litra	Gazoil D 1
3	AA 151 MD	Volkswagen	9Litra/100 km Ne muaj 300 litra	Gazoil D 1
4	AA 256 EG	Benz Mercedes	12 Litra/100 km Ne muaj 250 litra	Gazoil D 1
5	AA745 GB	Mercedez Benz	10litra/100 km ne muaj 300 litra	Gazoil D 1
6	AA 600 MJ	Volkswagen	8litra /100km	Gazoil D 1
7	AB 524 FY	Land Rover	13 litra/100 km muaj 400 lit	Gazoil D 1

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
<u>8</u>	<u>Ishte EL 0999 C</u> <u>U bë AB968OC</u>	<u>Benz Mercedes</u>	<u>12 Litra/100 km ne</u> <u>muaj 200 litra</u> <u>14 Litra/100 km ne</u> <u>muaj 400 litra</u>	<u>Gazoil D1</u>
<u>9</u>	<u>Ishte TR 6377H</u> <u>U bë AB 711 OC</u>	<u>Mitsubishi</u>	<u>20 Litra/100 km ne</u> <u>muaj 200 litra</u>	<u>Benzine</u>

POLICIA BASHKIAKE

Nr	Targa e mjetit	Tipi i mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
10	EL 8732 A	Mitsubishi Pajero	13.5 Litra/100 km ne muaj 300litra	Gazoil D 1
11	EL 3318 C	Karrotrez	22 Litra/100 km ne muaj 150 litra	Gazoil D 1
12	<u>Ishte :EL7475B</u> <u>U bë AB976OC</u>	<u>Benz</u> <u>Mercedez</u>	<u>10 Litra/100 km 200</u> <u>Litra ne muaj</u>	<u>Gazoil D 1</u>
13	AB 536 DF	Mitsubishi	12l/100 km ne muaj 300 Litra	Gazoil D 1
14	AB 560 DF	KIA	6.4 Litra /100 km 200 lit ne muaj	Benzine

SHERBIMI PYJOR

Nr	Targa e mjetit	Tipi i mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
15	AA 060 DJ	Toyota RAV 4	12 Litra/100 km ne muaj 100 litra	Gazoil D 1
16	EL 0738 C	Land Rover	14.4 Litra/100 km ne muaj 150 litra	Gazoil D 1

AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

	Targa e mjetit	Tipi imjetit	Norma e konsumit	Karburanti
		AUTOVINCAT		
1	EL 9043 B	Autovinc Benz	10 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
2	EL 5132 B	Autovinc Volkswagen	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
3	AA 624 PM	Nissan autovinc	10 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
		FADROMAT		
4	EL 1565 C	FadromeFermec	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
5	<u>Ishte :EL 1338C U bë :AJMT23</u>	<u>FadromeKomatcu</u>	<u>9 litra / 1 ore pune</u>	<u>Gazoil D 1</u>
6	<u>Ishte :EL9881B U bë:AB033OD</u>	<u>Fadrome JVC</u>	<u>8 litra / 1 ore pune</u>	<u>Gazoil D 1</u>
7	AB 132 BE	Fadrom fiat hitaci	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
8	AA 946 IV	Fadrome CATEPILAR	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
9		Fadrome Fiat Kobelco W130	10litra/1ore pune	Gazoil D1
		KAMIONCINAT		
10	EL 1519 B	Kamioncine Benz 3.7 Ton	17 litra / 100 km	Gazoil D 1
11	AB 773 CK	Kamioncin ford tranzit	12 litra /100 km	Gazoil D 1
12	AB 864 CK	Kamioncin ford tranzit	12 litra /100 km	Gazoil D 1
		FORISTRADAT		
13	AA 150 HY	Mitsubishi Fuoristrade	13 litra / 100 km	Gazoil D 1
14	TR 3690 S	Mitsubishi L 200	12 litra / 100 km	Gazoil D 1
15	EL 1606 C	Mitsubishi L 200	13 litra / 100 km	Gazoil D 1
16	AA 664 NB	Toyota ILUX	12litra/100 km	Gazoil D 1
		AUTOVETURAT		
17	AA 651 AO	Benz Mercedes	12 litra /100 km	Gazoil D 1
18	AB 357 NH	Volksv.Amarok	12 litra/100 km ne muaj 200 Litra	
		FURGONAT		

19	AA 126 OB	Ford-Tranzit	10Litra/100 km	Gazoil D 1
		ESKAVATOR		
20		Eskavator Volvo ECR 88	7 lit/ore	Gazoil
21	ATMB 86	Eskavator me goma FIAT HITACHI	17L/1 ore pune	Gazoil
		Eskavator Hitachi EX-220lc	22 l/1 ore pune	
22		Rul deri 12.90T	12L/1 ore pune	Gazoil
23		Rul deri 12.9T(vibrim)	20L/me vibrim	Gazoil
24		Rul I vogel pioner	3 L/1 ore pune	Gazoil
25		Minieskavator ET-16	3.5 litra/ore	GAZOIL D1
26		Mini Eskavator ET-18	3.5LITRA/ore	
		TRAKTOR		
27		Traktor Kiat Kobelko FD 30C	20 litra/ore	GAZOIL D1
28		Traktor FT 125	22 litra/ore pune	GAZOIL D1
		KAMIONAT		
29	EL 5513 B	MakineKamion Benz	35 litra / 100 km	Gazoil D 1
30	EL 5509 B	Makine Kamion Benz	35 litra / 100 km	Gazoil D 1
31	EL 1427 C	Makine Kamion Benz	35 litra / 100 km	Gazoil D 1
32	AB 131 BE	Kamion man	40litra /100 km	Gazoil D 1
33	AB 156 BE	Kamion benz	45 litra /100 km	Gazoil D 1
		MAKINAT E PASTRIMIT		
34	AA 013 VL	Makine Pastrimi Iveco	4 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
	TR 8683 L	Makine pastrim Volvo FL 6	4 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
35	AA 014 VL	Makine Pastrimi Iveco	4 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
36	AB 236 HS	Makine pastrimi Iveko	3.5 Litra/1 ore pune	Gazoil D 1
37	AB 320 HS	Makine pastrimi FORD	5 Litra/1 ore pune	Gazoil D 1

Nr	TARGA	Mjete motorike	Norma e konsumit	Karburanti
38		Gjenerator 10 kw	0.7 l/ore	Gazoil D 1
39		Betoniere	1 Lit /1 m3	Benzine
40		Motorseke	0.6 l/ore	Benzine
41		Korse Bari	0.5 l/100 m2	Benzine
42		Motorrsharre Bordurash	0.6 l/ ore pune	Benzine
43		Freze	3.5L/1ore pune	Benzine
44		Motorrkorse me rrota	0.6l/100m2	Benzine
47		Motorrsaldatrice IANCIU	1.5l/ 1ore pune	Benzine

NORMATIVAT DHE KUOTAT MUJORE TE HARXHIMIT TE KARBURANTITPER VITIN 2024
PER MJETET ZJARREFIKESE:

Nr	TARGA	TIPI I MJETIT	LLOJI I LENDES DJEGESE	NORMATIVA PER CDO MJET
1	AA 152 UZ	Benz 1222	Diesel D1	Per 100 km 30lit/ per 1 ore ndezje ne vend 10 lit gazoil
2	AA 153 UZ	Benz 1117	Diesel D1	Per 100 km 17 /litra per 1 ore ndezje ne vend 7 litra gazoil
3	AA 154 UZ	Benz Autoskoll	Diesel D1	Per 100 km 27 /litra per 1 ore punedhe 1 ore ndezje ne vend 9 litragazoil
4	AA 155 UZ	Reno S 150 Midliner	Diesel D1	Per 100 km 20L per 1 ore pune dhe nje ore ndezje ne vend 9 L gazoil
5	AA 156 UZ	Reanult Unimong	Diesel D1	Per 100 km 33 litra per 1 ore punedhe 1 ore ndezje ne vend 10 lit gazoil

6	AB 856 EK	Furgon Ford	Diesel D1	12 L/100KM
7	Nukka	Iveko 175 24	Diesel D1	Per 100 km 33 litra per 21 ore punedhe 1 ore ndezje ne vend 12 lit gazoil
8	Polic 1307	Kamioncin Volswagen	Diesel D1	Per 100 km 12 litra/gazoil
9		Gjenerator I paisjeve te shpetimit	Benzin	Per 1 ore pune dhe 1 ore ndezje ne vend dhe harxhon 1.5 L/Ben
10		Motorsharre Stihl	Benzin	Per 1 ore pune harxhon 1.5L/benzin
11		Troko per prerje betoni dhe metale	Benzin	Per 1 ore pune harxhon 1.5L/benzin
12		Ventilator per pastrimin e tymit	Benzin	Per 1 ore pune harxhon 1.5L/benzin
13		Pompe thithese uji lambordini	Diesel D1	Per 1 ore pune harxhon 5 L/benzin
14		Pompe thithese uji mitsubishi	Benzine	Per 1 ore pune 3 litra

NORMATIVAT DHE KUOTAT MUJORE TE HARXHIMIT TE KARBURANTIT PER VITIN 2024 PER MJETET MOTORIKE TE QENDRES BALASHE:

Nr	TARGA	TIPI I MJETIT	LLOJI I KARBURANTIT	KONSUMI DITOR
1	EL 4389 C	Volkswagen	Gazoil D1	15litra /100 km
2	AA 382 FY	OPEL VIVARO	Gazoil D1	13 lit /100 km
3	AA 107 SY	Volkswagen Cady	Gazoil D1	15 litra /100 km

NORMATIVAT DHE KUOTAT MUJORE TE HARXHIMIT TE KARBURANTIT PER VITIN 2024
PER MJETET DHE PAISJE QE PERDOREN NGA DREJTORIA E QENDRES EKONOMIKE TE
ARSIMIT:

Nr	TARGA	TIPI I MJETIT	LLOJI I KARBURANTIT	KONSUMI DITOR
1	EL 3319 C	Benz	Gazoil D1	13 litra /100 km
2	EL 7138 B	Ford Tranzit	Gazoil D1	14 litra /100 km
3	AA 035 AG	Volkswagen	Gazoil D1	9 litra /100 km

LISTA E MAKINAVE PER ADMINISTRATORET:

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
1	AA 579 EC	Volkswagen	8 lit/100 km Ne muaj 50 Litra	Benzine
2	AA 140 HM	Autoveture	7Litra/100 km Ne muaj 50 litra	Benzine
3	AB 082 ER	Mercedez Benz	8 Litra/50 km Ne muaj 250 litra	Gazoil D 1
4	AA 668 YD	Wolkswagen golf	8 litra/100 km ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
5	AA 950 KC	Audi	8 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
6	Ishte AB 445 DF U bë AB 446 IO	Mercedes Benz	8 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
7	AB 448 AB	Auto Volksw.	9 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
8	AB 869 EE	Auto Opel	7 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
9	AA 171 OE	Auto Ford	6Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
10	AA 184 UZ	Wolkswagen Pasiat	8 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
11	AA 628 KD	Auto Ford	5Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1

12	AB 175 FF	Nissan	6 Litra/100 km ne muaj 50 litra	Gazoil D1
13	AA 950 KC	Damiler Chrysler	8 Litra/100 km ne muaj 50 litra	Gazoil D1
14	<u>U bë :AB 029 ER</u> <u>Ishte:AB 082</u> <u>ER</u>	<u>Mercedes Benz</u>	<u>8 Litra/100 km ne muaj</u> <u>50 litra</u>	<u>Gazoil D1</u>
15	<u>U bë:AB446 IO</u> <u>Ishte :AB445DF</u>	<u>Mercedes Benz</u>	<u>8 Litra/100 km ne muaj</u> <u>50 litra</u>	<u>Gazoil D1</u>
16	<u>U bë:AB 489 NC</u> <u>Ishte:AA668YD</u>	<u>Hyundai</u>	<u>8 Litra/100 km ne muaj</u> <u>50 litra</u>	<u>Gazoil D1</u>

Konceptoi: Drilona Mema

Pergj/Sekt. Mekanik :

Gazmend Gaxhaj

Miratoi

Drejtori I Pergjithshem

Altin Cenolli

3073 / 2

12.07.2024

14



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 751 / prot.

Elbasan, më 12.7.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.62 dt.03.07.2024 “Për një ndryshim në VKB nr.29 datë 28.03.2024 “Për një ndryshim në VKB nr.6 datë 26.01.2024 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR“, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI



Ali MYSLIU



5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 3074/1, prot.Elbasan, më 05 . 07 .2024

VENDIM

Nr. 63 Datë 03/07/2024

“Për dhënien me qera të 300 kontenierëve të mbetjeve urbane nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale tek Kompania e pastrimit VIOLA – GREEN sh.p.k .

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, V.K.B Nr 111 Datë 03.09.2020 “ Rregullorja e administrimit të mbetjeve në Bashkinë Elbasan për vitin 2020 – 2025 si dhe VKM Nr. 54 Dt. 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore” i ndryshuar, paragrafi III, pika 5: Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfitozë”, Urdhërit Nr 1250 datë 06.06.2023 i Kryetarit të Bashkisë “ Për Ngritjen e grupi të punës për përgatitjen e dokumentacionit tekniko – ekonomik për shërbimin e pastrimit në Njësitë Administrative Labinot Fushë, Shushicë, Shiringjan, Gjergjan, Bradashesh dhe Papër “ dhe Kontratës Publike për Shërbim me Nr 4459/18 Prot datë 30.11.2023 lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe Kompanisë Viola-Green sh.p.k. Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale, në mbledhjen e tij të datës 3 /07 /2024

VENDOSI:

1. Të jepen me qira 300 kontenierë të mbetjeve urbane pronë e Agjencisë së Shërbimeve Rurale Bashkia Elbasan. Kompanisë Viola Green Shpk me afat 24 muaj sipas kontratës së shërbimit me Nr. 4459/18 Prot Dt. 30.11.2023 lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe Kompanisë Viola Green sipas përcaktimeve të mëposhtme.

Emërtimi i Mallit	Njësia (cope)	Çmimi	Vlera	Amortizimi Akumuluar	Vlera e mbetur (here 10%)	Qera Vlera lek
Kontenierë mbetje viti 2017	14	34800	487200	359982	127218	12722
Kontenierë mbetje viti 2018	4	34800	139200	102852	36348	3635
Kontenierë viti 2018	128	36600	4684800	3461505	1223295	122329

Kontenierë viti 2018	1	36600	36600	24654	11946	1195
Kontenierë viti 2019	1	36600	36600	24654	11946	1195
Kontenierë viti 2020	125	39300	4912500	25565000	2358000	235800
Kontenierë viti 2021	1	39300	39300	17921	21379	2138
Kontenierë viti 2021	4	39300	157200	71683	85517	8552
Kontenierë viti 2021	4	39300	157200	70006	87194	8719
Kontenierë viti 2022	18	23400	421200	151632	269568	26957
TOTALI	300			Vlera per	1 vit	423242
				Vlera per	2 vjet	846484

2. Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale lidh kontratë qëraje 24 muaj me kompanin Viola Green Shpk sipas kontratës së shërbimit me Nr. 4459/18 Dt. 30.11.2023 lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe kësaj kompanie.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia Shërbimeve Publike Rurale dhe Drejtoria e Koordinimit dhe monitorimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konceptoi: Përgj. Ekonomik Burbuqe Dedja

Pranoi: Drejtori Përgjithshëm: Altin Cenolli



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Elvi Cuni



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



3074/2

3

12.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 752/1 Prot.

Elbasan më 12.7.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.63 datë 03.07.2024 “Për dhënien me qera të 300 kontenierëve të mbetjeve urbane nga Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale tek Kompania e pastrimit VIOLA-GREEN sh.p.k”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ali MYSLIU

9
5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 3079 prot.

Elbasan, më 20. 06. 2024

RELACION

“Për dhënien me qera të 300 kontenierëve të mbetjeve urbane nga Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale tek Kompania e pastrimit VIOLA – GREEN sh.p.k .

Të nderuar këshilltarë,

KËSHILLIT BASHKIAK

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” , V.K.B Nr 111 Datë 03.09.2020 “ Rregulloja e administrimit të mbetjeve në Bashkinë Elbasan për vitin 2020 – 2025 “ si dhe Urdhërit Nr 1250 datë 06.06.2023 i Kryetarit të Bashkisë “ Për Ngritjen e grupi të punës për përgatitjen e dokumentacionit tekniko – ekonomik për shërbimin e pastrimit në Njësitë Administrative Labinot Fushë, Shushicë, Shirgjan, Gjergjan, Bradashesh dhe Papër “ dhe Kontratës Publike për Shërbim me Nr 4459/18 Prot datë 30.11.2023 lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe Kompanisë Viola-Green sh.p.k ju bëjmë me dije se :

Bashkia ndër vite ka blerë kontenierë për nevojat e saj për shërbimin e pastrimit në zonat rurale. Duke qenë se tani në 6 Njësi Administrative ky shërbim, duke filluar nga data 01.12.2023 deri me 30.11.2025 realizohet nga kontraktori privat,dhe janë parashikuar në kontratën e Sipërmarrjes Publike për Shërbime 585 kontenierë.Atehëre,kemi një tepricë prej 300 kontenierësh të cilat mendojmë ti japim me qera tek ky operator sic është parashikuar në kontratë dhe sic e përcakton V.K.M Nr 54 datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”.(Ndryshuar me VKM nr.735,datë 5.11.2014,nr.445,datë 20.05.2015,nr.992,datë 9.12.2015,nr.299,datë 20.04.2016,nr.606,datë 31.08.2016,nr.693,datë 5.10.2016). (I përditësuar)Paragrafi III.Tarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë pika 1,pika 5.

Për të 6 njësite administrative është respektuar vendodhja aktuale e kontenierëve dhe kemi shtesa të tyre sipas hartës të hartuar nga komisioni përkatës.

Kontenierët e mbetjeve urbane 1,1 m³ që do të jepen me qera

Emërtimi I Mallit	Njësia (cope)	Çmimi	Vlera	Amortizimi Akumuluar	Vlera e mbetur (here 10%)	Qera Vlera lek
Kontenierë mbetje viti 2017	14	34800	487200	359982	127218	12722
Kontenierë mbetje viti 2018	4	34800	139200	102852	36348	3635
Kontenierë viti 2018	128	36600	4684800	3461505	1223295	122329
Kontenierë viti 2018	1	36600	36600	24654	11946	1195
Kontenierë viti 2019	1	36600	36600	24654	11946	1195
Kontenierë viti 2020	125	39300	4912500	25565000	2358000	235800
Kontenierë viti 2021	1	39300	39300	17921	21379	2138
Kontenierë viti 2021	4	39300	157200	71683	85517	8552
Kontenierë viti 2021	4	39300	157200	70006	87194	8719
Kontenierë viti 2022	18	23400	421200	151632	269568	26957
TOTALI	300					

Shuma për 1 vit

423242 leke

Shuma për 2 vite

846484 leke

Bashkangjitur kopje e urdhërit të Kryetarit të Bashkisë për grupin e punës për hartimin e dokumentacionit tekniko-ekonomik për shërbimin e pastrimit në 6 Njësitë Administrative, e kontratës shërbimit të pastrimit, informacion për inventarët e kontenierëve me të dhënat kontabël.

Duke Ju falenderuar,

Konceptoi: Përgj. Ekonomik Burbuqe Dedja

Pranoi: Drejtori Përgjithshëm : Altin Cenolli

ZV / KRYETAR
Aulona BYLYKBASHI





REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E BUXHET - FINANCËS

Nr. 3070/1 prot.

Elbasan, më 05.07.2024

VENDIM

NR. 64 DATË 03 . 07 2024

MBI

“Transferimin e investimeve, të financuara nga EuropeAid/170339/DD/ACT/MK: Cross-border Cooperation Programme Republic of North Macedonia-Republic of Albania under the Instrument of Pre-accession Assistance (IPA II) allocations for 2018-2020, Contract Number IPA/2021/429-426, Project title: Krushevo and Elbasan – acknowledged CB tourism destination me referencë 03/2022, Agjensisë së Kulturës dhe Turizmit”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 3 .07.2024, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan “Për miratimin në parim të transferimit të investimeve, të financuara nga EuropeAid/170339/DD/ACT/MK: Cross-border Cooperation Programme Republic of North Macedonia-Republic of Albania under the Instrument of Pre-accession Assistance (IPA II) allocations for 2018-2020, Contract Number IPA/2021/429-426, Project title: Krushevo and Elbasan – acknowledged CB tourism destination me referencë 03/2022, Agjensisë së Kulturës dhe Turizmit”, bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

VENDOSI:

1. Transferimin e investimeve për projektin “Ndërtimi i qendrës informuese turistike dhe pistës së parashutizmi Funar”, si dhe projektin “Itinerari si tërheqje turistike Elbasan-Funar” Agjensisë së Kulturës dhe Turizmit si më poshtë:

Projekti	Bashkia Elbasan	OJF Tjetër Vizion	Totali
Ndërtimi i qendrës informuese turistike dhe pistës së parashutizmit Funar	3,919,640	19,598,197	23,517,837
Itinerari si tërheqje turistike Elbasan-Funar	3,521,621	2,210,909	5,732,530
Shuma	7,441,261	21,809,106	29,250,367

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet/Financës dhe Agjencia e Kulturës dhe Turizmit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETARI
ELVI ÇUNI




KRYETARI
LUTFI LALA



Dr. Përgjithsh.: G.Dyrmyshi

Dr. Buxhet/Financës: A.Merkja

Dr. Juridike: A.Hoxha



3070/2

12.07.2024

3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 753/prot.

Elbasan, më 12.7.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr. 64 dt.03.07.2024 “Për miratimin transferimin e investimeve të financuara nga EuropeAid/170339/DD/ACT/MK: Cross-border Cooperation Programme Republic of North Macedonia-Republic of Albania under the Instrument of Pre-accession Assistance (IPA II) allokatione for 2018-2020, Contract Number IPA/2021/429-426, Projekt title: Krushevo and Elbasan – acknowledged CB tourism destination me reference 03/2022, Agjensisë së Kulturës dhe Turizmit“, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ali MYSLIU





754
05.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATOREVE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCËS

Nr. 3076/1 Prot.

Elbasan, më 05.07. 2024

Vendim

Nr 65 Datë 03/07/2024

Për miratimin e marrëveshjes dhe llogaritje ne buxhet.

Në kuadër të miratimit të marrëveshjes së lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqatës për Autonominë Vendore për çertifikimin e Bashkisë Elbasan si bashkia më miqësore me bizneset, duke u mbështetur edhe në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” nenet: 8,9, 54 dhe ligjit: 68/2017 Për Financat e Bashkëqeverisjes Vendore”.

VENDOSI

- 1.Mbi miratimin në parim të “Kontrates se lidhur midis Bashkise Elbasan dhe Shoqatës për Autonominë Vendore” për zbatimin e procedurës së vlerësimit të Vetëqeverisjes Vendore me mjedis të favorshëm biznesi.
2. Futjen në buxhetin e vitit 2024 bashkëfinancimin e Bashkisë Elbasan, sipas detyrimeve të marrëveshjes së lidhur.
3. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan: Buxhet-Finances, Drejtoria e Integrimit Evropian Projekteve dhe Donatoreve, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e Inovacionit dhe Teknologjise, Drejtoria e Sherbimeve dhe Drejtoria Juridike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: S.S.P.D B.Alterziu

P.S.P.D K.Kreka

Pranoi: DIEPSI K.Qosja

Miratoi: D.B.F A.Merkja

D.D.J A.Hoxha

DP.ZHE S. Mehmeti

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Cuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Date nga arkivi Bashkisë Elbasan
date 18.07.2024.

P/Arkivi

zr/Kryetar

Aida Talelli

Asim Sula,



Bashkia Elbasan
Nr.3337 Datë 13.10.2023

SHOQATA
PER AUTONOMINE
VENDORE

Shoqata për Autonomi Vendore
Nr.272 Datë 13.10.2023



KONTRATË

Për zbatimin e procedurës së vlerësimit të vetëqeverisjeve vendore me mjedis të favorshëm
biznesi (BFC SEE)

Bashkia Elbasan

Adresa: Rruga 11 Nëntori, Elbasan

Kodi postal: 3001

Vat/NIPT: K52905207B

Përfaqësuar nga Kryetari i bashkisë Z. Gledian Llatja, lindur dhe banues në Elbasan, i datëlindjes
31/03/1981, me numër personal I10331053C.

Shoqata për Autonomi Vendore

Adresa: Rruga "Brigada e VIII", pallati 130, hyrja 2, ap 8, Tiranë.

Kodi postal: 1001

VAT (NIPT): L01327453K

Përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Zj Adelina Farrici, lindur në Burgajet dhe banuese në Tiranë,
e datëlindjes 08/04/1968, me numër personal G85408092R.

Duke pasur parasysh:

(A) se Shoqata për Autonomi Vendore si anëtare e network rajonal për një mjedis të favorshëm
biznesi në Europën Juglindore, zbaton programin e certifikimit të bashkive me mjedis të favorshëm
biznesi sipas standardit BFC SEE Edicioni IV

(B) se Bashkia Elbasan, me ambicjen për krijimin dhe promovimin e një ambjenti të favorshëm
për zhvillimin ekonomik vendor në territorin nën juridiksionin e saj, është e interesuar për zbatimin
e procedurës së vlerësimit, për marrjen e certifikates, për përmbushjen e standardit BFC SEE
Edicioni IV

palët kontraktuese me vullnet të lirë bien dakord si në vazhdim:

Baza ligjore:

Kjo kontratë bazohet në nenin 8, 9, 28, nenin 34, pika 3, nenin 35 pika 1/d, nenin 36 pika 2, dhe nenin 64, shkronjat "a" dhe "gj", të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar), ligjin nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjen Vendore", nenet 659 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar).

Neni 1 Lënda

Qëllimi i kësaj Kontrate është të vendosë bashkëpunim ndërmjet Palëve të saj, të përcaktojë fushat kryesore të veprimit të përbashkët dhe të drejtat dhe detyrat e ndërsjellta. Qëllimi përfundimtar i të gjitha aktiviteteve që ndërmarrin Palët e Kontratës është krijimi i një mjedisi të favorshëm të biznesit në rajonin e Evropës Juglindore përmes përmbushjes së kriterëve dhe kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV nga ana e Bashkisë.

Në bazë të kësaj Kontrate Shoqata për Autonomi Vendore do të kryejë këto veprime për zbatimin e procedurës së vlerësimit të mjedisit të favorshëm të biznesit sipas kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV:

- Informon bashkinë me kërkesat dhe kriteret e standardit BFC SEE Edicioni IV;
- shqyrton dokumentacionin e marrë me anë të cilit dëshkohet përmbushja e kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV nga ana e bashkisë;
- organizon procesin e vlerësimit (emërimi i ekipit të vlerësimit, hartimi dhe harmonizimi i planit të vlerësimit, organizimi i udhëtimit dhe akomodimit për vlerësuesit);
- i dërgon udhëzimet BFC SEE bashkisë (Manuali BFC SEE, udhëzusi i përdorimit BFC SEE për zbatimin elektronik të procesit të certifikimit);
- ofron ndihmë profesionale dhe teknike gjatë procesit të vlerësimit të përmbushjes së kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV;
- zbaton vlerësimin eventual të bashkisë në përputhje me kërkesat e standardit BFC SEE Edicioni IV;
- harton raportin e kontrollit vlerësues (paraprak dhe përfundimtar) me pikët e përmbushjes së kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV;
- përgatit kontrollin verifikues (emërimi i komisionit verifikues, hartimi dhe harmonizimi i planit të vlerësimit, organizimi i udhëtimit dhe akomodimit për vlerësuesit) në rast të përmbushjes së kushteve të caktuara dhe kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV;
- zbaton kontrollin verifikues të bashkisë në përputhje me kërkesat e standardit BFC SEE Edicioni IV;
- harton Raportin e kontrollit vlerësues (Verifikues) me notën e përmbushjes së kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV;
- jep vërtetim dhe certifikatë për përmbushjen e kriterëve të standardit BFC SEE Edicioni IV në bazë të vendimit të Këshillit Rajonal të BFC SEE;
- jep lejen për përdorimin e shenjës BFC SEE në periudhën e vlefshmërisë së certifikatës së lëshuar nga ana e Shoqatës për Autonomi Vendore.



Kjo kontratë nuk parashikon asnjë shërbim konsulence nga fusha e cila është e mbuluar nga lënda e kontratës.

Neni 2 Zbatimi i vlerësimit

Shoqata për Autonomi Vendore do të kryejë vlerësimin dhe evidentimin e mjedisit të favorshëm të biznesit në teritorin e Bashkisë. Vlerësimi kryhet në selinë e bashkisë nga ana e vlerësuesve të emëruar. Konsiderohet se procedura e vlerësimit është kryer kur Shoqata për Autonomi Vendore ia dorëzon Bashkisë Raportin e vlerësimit të aprovuar nga ana e Këshillit Rajonal të BFC SEE. Në rast të rezultatit negativ të certifikimit, Shoqata për Autonomi Vendore e njofton Bashkinë me anë të Raportit.

Në bazë të Raportit të vlerësimit pozitiv të aprovuar të Shoqatës për Autonomi Vendore për vlerësimin e zbatuar, Bashkisë i lëshohet Certifikata BFC SEE ("Certifikata").

Pas lëshimit të certifikatës, sipas dinamikës së përcaktuar dhe rregullave të cilat i cakton Programi BFC SEE, Shoqata për Autonomi Vendore do të kryejë kontrollin mbikëqyrës.

Nëse nuk kryhet kontrolli mbikëqyrës ose me anë të saj vërtetohet se Bashkia nuk i përmbush kërkesat e Standardit BFC SEE Edicioni IV ose kushtet e caktuara në Kushtet e përgjithshme të certifikimit të vetqeverisjeve vendore me mjedis të favorshëm biznesi, sipas të cilave iu është lejuar Certifikata, Shoqata për Autonomi Vendore ka të drejtë të tërheqë Certifikatën nga Bashkia. Para tërheqjes së Certifikatës, me njoftim paraprak të Sekretariatit Teknik Rajonal, Shoqata për Autonomi Vendore mund ti caktojë Bashkisë një periudhë adekuate në kuadër të së cilës Bashkia është e detyruar të eliminojë të gjitha mangësitë në zbatimin e standardit. Nëse Bashkia në periudhën e dhënë nuk i eliminon të gjitha mangësitë e caktuara, Certifikata tërhiqet menjëherë pas skadimit të asaj periudhe. Tërheqja e Certifikatës i paralajmërohet me shkrim bashkisë nga ana e Shoqatës për Autonomi Vendore (7 ditë para tërheqjes).

Pas tërheqjes së Certifikatës, Bashkia nuk mund të përdorë shenjën e certifikimit në mediat e shkruara dhe elektronike ose të përdorin të drejtat tjera në lidhje me Certifikatën.

Neni 3

Me lëshimin e Certifikatës, Shoqata për Autonomi Vendore i lejon Bashkisë përdorimin e Certifikatës për një periudhë 3 (tre) vjeçare nga data e lëshimit, përveç nëse Certifikata nuk është marrë gjatë zbatimit të kontrollit mbikëqyrës (sipas paragrafit 4, pika 2 e kësaj Kontrate). Shoqata për Autonomi Vendore i lejon Bashkisë përdorimin e shenjës së Certifikatës në përputhje me udhëzimin për përdorim që do ti dërgohet Bashkisë.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Gjoni", is written to the right of the official stamp.

Neni 4
Shpenzimet financiare

Për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet e parashikuara në nenin 1 të kësaj kontrate, Bashkia do t'i paguajë Shoqatës për Autonomi Vendore shumën deri në 4.500 (katër mijë e pesëqind) EUR e këmbyer në lekë me kursin e Bankës së Shqipërisë në ditën e pagesës, pagesë e cila kryhet sipas kërkesës së shoqatës për aktivitetet e kryera.

Pagesa mund të kryhet pjesore sipas aktiviteteve të kryera apo në një pagesë të menjëhershme pas kryerjes së procedurës së vlerësimit, sikurse parashikohet në nenin 2 të kësaj kontrate. Shuma si më sipër do të miratohet paraprakisht nga Këshilli Bashkiak. Bashkiak. Në rast mosmiratimi të fondit të financimit nga këshilli bashkiak, Bashkia do të njoftojë shoqatën për pezullimin e zbatimit të kontratës, deri në garantimin e fondit si më sipër.

Të dhënat e llogarisë për kryejën e pagesës janë si më poshtë vijon:

Banka: OTP Albania
Nr Llogarisë: 00001369903
IBAN: AL10 2131 1013 0000 0000 0136 9903
SËIFT: PUPPALTR

Një pjesë e shpenzimeve të vlerësimit të certifikimit në shumën prej 4215 (katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) EUR mbulohet në kuadër të projektit „Establishing Business Friendly Environment Platform in EB6 të cilin e mbështet Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)“.

Shpenzimet e vlerësimit certifikues përfshijnë të githa shpenzimet e Shoqatës për Autonomi Vendore të krijuara për nevoja të procesit administrativ të procedurës së certifikimit si dhe shpenzimi i kërkimit dhe lëshimit të certifikatës nga ana e Shoqatës për Autonomi Vendore.

Neni 5
Të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese

Bashkia është e detyruar që:

- të sigurojë mbrojtje të shëndetit të personelit të Shoqatës për Autonomi Vendore gjatë kohës së zbatimit të vlerësimit;
- të sigurojë bashkëpunim të plotë gjatë zbatimit të procedurës së përmbushjes së kriterëve të standardit BFC SEE Edicioni IV;
- të formojë Ekipin për certifikim dhe të emërojë koordinatorin e ekipit dhe personin përgjegjës për dhënien e informacionit në kuadër të softuerit BFC SEE;
- në afatet e caktuara, të sigurojë dokumentacionin/linqet dhe informacionet tjera relevante në formatin e duhur që janë të domosdoshme për zbatimin e kontrollit;
- me qëllim të shmangies së keqpërdorimit të të dhënave, akses në llogarinë e përdoruesit ka vetëm personi i autorizuar dhe të dhënat e aksesit nuk ia jep për përdorim personave tjerë;
- të zbatojë rekomandimeve nga Raporti paraprak i vlerësimit;



- të eliminojë mangësitë e mundshme të vëna re gjatë kontrollit mbikëqyrës në periudhën e caktuar shtesë;
- t'ia kthejë certifikatën Shoqatës për Autonomi Vendore, që iu është tërhequr në bazë të Raportit të Shoqatës për autonomi Vendore gjatë kontrollit mbikëqyrës;
- të përdorë logon e certifikatës BFC SEE në përputhje me Rregullat e përdoroimit të shenjës së certifikatës dhe të zgjidhjes grafike, për të cilën do të marrin udhëzime nga Shoqata për autonominë Vendore me rastin e marrjes së certifikatës;
- Shenja e certifikimit të BFC SEE nuk mund të vendoset në produkte dhe nuk mund të përdoret në lidhje me aktivitetet që nuk janë pjesë e kësaj kontrate. Shenja e certifikimit do të përdoret vetëm për aktivitetet të cilat janë lëndë e kësaj Kontrate;
- pas tërheqjes së Certifikatës ndalohet përdorimi i metejshëm i logos dhe bëhet heqja e menjëherëshme e logos nga të gjitha ambjentet ku është vendosur Certifikata.;
- të zbatojë tërë procesin e certifikimit në afat prej 12 muajsh nga momenti i lidhjes së kontratës.

Bashkia ka të drejtë që:

- të informohet për përbërjen e ekipit të vlerësimit dhe për rezultatet/pikat në procedurën e vlerësimit të përmbushjes së kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV;
- të kërkojë nga Shoqata për Autonomi Vendore sqarime në lidhje me vlerësimin me pikë të përmbushjes së kërkesave të standardit BFC SEE Edicioni IV;
- të marrë pjesë në aktivitetet të cilat janë në lidhje me certifikatën, dhe të cilat zbatohen në selinë e tyre.
- në përputhje me Librin e standardeve grafike të përdorë shenjën BFC SEE në periudhën e vlefshmërisë së certifikatës (tri vjet) për nevoja të promovimit edhe atë në kuadër të dokumenteve të cilat lidhen me aktivitetet e certifikimit dhe të dhëna në fushën e aplikimit të certifikimit (psh. materialet promovuese, memorandum, dokumentacioni i biznesit, etj.);
- të bëjë kërkesën për ricertifikim në vitin e fundit të vlefshmërisë së certifikatës BFC SEE.

Shoqata për Autonomi Vendore është e detyruar:

- të sigurojë zbatimin e vlerësimit në mënyrë të paanshme, me përgjegjësi profesionale, njohuritë e duhura teknike dhe praktikën, duke respektuar nenet e kësaj Kontrate, kushtet e kësaj Kontrate dhe rregullat ligjore në fuqi;
- të njoftojë bashkinë për ndryshimet e Kushteve të përgjithshme të certifikimit.

Shoqata për Autonomi Vendore ka të drejtë që:

- të kërkojë nga bashkia bashkëpunimin e domosdoshëm.

Neni 6

Ndryshimi i kontratës



[Handwritten signature in blue ink]

Kontrata mund të ndryshohet vetëm nëse të dyja palët arrijnë marrëveshje me shkrim. Pala propozuese duhet t'ia bëjë të ditur propozimin palës tjetër jo më vonë se dy javë përpara.

Neni 7 Tërheqja nga kontrata

Shoqata për Autonomi Vendore mund të ndërpresë kontratën në mënyrë të njëanshme në rast të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuese nga ana e Bashkisë. Në rast të mospërbushjes së obligimeve nga ana e Bashkisë, Shoqata për Autonomi Vendore ka të drejtë të ndalojë procedurën e vlerësimit dhe të gjithë procesit duke caktuar një afat shtesë për zbatimin e detyrimeve të bashkisë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15(pesëmbëdhjetë) ditë. Në rast se Bashkia nuk përmbush obligimin as në afatin shtesë, kontrata ndërpritet me njoftim me shkrim që hyn në fuqi në ditën e marrjes së njoftimit.

Në rast të tërheqjes nga Kontrata nga ana e bashkisë, bashkia është i detyruar që ti paguajë Shoqatës për Autonomi Vendore shpenzimet e krijuara gjatë përgatitjes dhe zbatimit të vlerësimit respektivisht të gjitha shpenzimet e krijuara deri në momentin e tërheqjes nga Kontrata nga ana e bashkisë.

Neni 8 Konfidencialiteti

Të dyja palët kontraktuese obligohen që i gjithë informacioni i marrë nga ana e palës tjetër kontraktuese do të trajtohet si rreptësisht konfidenciale, edhe pas ndërprerjes së vlefshmërisë së kësaj kontrate, në periudhë 10 (dhjetë)vjeçare.

Palët kontraktuese janë dakord që për qëllime të përmbushjes së kësaj Kontrate dokumentat dhe të dhënat të cilat Bashkia ia dërgon Shoqatës për Autonomi Vendore në kuadër të procesit të certifikimit mund të përdoren për qëllime analitike dhe të publikohen për qëllime promovimi, përveç nëse bëhet fjalë për konfidencialitet biznesi për të cilën Bashkia është i obliguar që të njoftojë Shoqatën për Autonomi Vendore. Të dhënat të cilat dhënësi i informacionit i shënon si sekret biznesi, pala tjetër kontraktuese është e obliguar ti trajtojë si rreptësisht konfidenciale, në afat të pacaktuar. Në rast të shkeljes së këtij obligimi, pala e kundërt ka të drejtë të kërkojë kompensim të dëmit real të shkaktuar. Përjashtim nga obligimi paraqesin rastet kur palës kontraktuese dhënia e informacionit iu është kërkuar nga ana e organeve shtetërore kompetente.

Bashkia obligohet që të respektojë të drejtat e autorit në lidhje me literaturën BFC SEE e cila iu është dhënë në kuadër të programit (manuali BFC SEE, udhëzimet, formularët dhe materialet tjera) dhe të njëjtat ti trajtojë si sekret biznesi. Materiali BFC SEE nuk mund të riprodhohet ose të përdoret në çfarëdo forme ose me asnjë mjet, elektronik ose mekanik, duke përfshirë fotokopjimin ose publikimin në internet, pa dakordim paraprak me shkrim të Sekretariatit Teknik Rajonal.

Neni 9



Palët kontraktuese deklarojnë se kanë lexuar këtë kontratë, se dakordohen me përmbajtjen e saj dhe se kjo kontratë është përpiluar me mirëbesim dhe vullnet të lirë dhe nuk është lidhur në kohë vështirësie ose në kushte të pavolitshme të njëanshme.

Të gjitha mosmarrëveshjet palët kontraktuese do të përpiqen ti zgjidhin me marrëveshje, dhe në rast të pamundësisë së arritjes së marrëveshjes, palët kontraktuese mund t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 10 Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn pas nënshkrimit të saj nga palët dhe miratimit nga Këshilli Bashkiak
Kjo kontratë hartohet në 4(katër) kopje, nga të cilat Bashkia dhe Shoqata per Autonomi Vendore marrin nga dy kopje.

**Bashkinë Elbasan
Kryetari I Bashkisë
Z. Gledian Llatja**



**Shoqata për Autonomi Vendore
Drejtori Ekzekutiv
Zj. Adelina Farriçi**



Handwritten signature in blue ink.





3076/2
12.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 754/ Prot.

Elbasan më 12.7.2024

Lënda: Konfirmim akti


KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.65 datë 03.07.2024 "Për miratimin e marrëveshjes dhe llogaritje në buxhet", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ali MYSLIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3150/1 Prot.

Elbasan 05.07.2024

VENDIM

Nr. 66 datë: 03.07.2024

I "Për miratimin e tarifave për mjetet e lundrimit për zbavitje (kanoe, kayak, standpaddle) dhe për biçikletat në zyrën e Infopoint Funar".

II. "Për miratimin e tarifave të reja për biletat e Muzeut Etnografik sipas kategorive të përcaktuara".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 03.07.2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjensia e Kulturës dhe Turizmit, 1. "Për miratimin e tarifave për mjetet e lundrimit për zbavitje (kanoe, kayak, standpaddle) dhe për biçikletat në zyrën e Infopoint Funar".

2. "Për miratimin e tarifave të reja për biletat e Muzeut Etnografik sipas kategorive të përcaktuara". Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 36, pika 3, të ligjit 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar.

VENDOSI:

- Tarifimin e mjeteve të lundrimit për zbavitje (kanoe, kayak, standpaddle) dhe për biçikletat si më poshtë:
 - Kanoe-çift/Kayak me qera, 500 lekë/ora.
 - Standpaddle me qera, 500 lekë/ora.
 - Biçikleta me qera 200 lekë/ora.
 - Për nxënës dhe studentë 100 lekë/ora.
- Tarifimin për biletat e reja të Muzeut Etnografik sipas kategorive të përcaktuara më poshtë.
 - Vizitorë vendas dhe të huaj 200 lekë.
 - Nxënës dhe studentë 50 lekë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Elvi ÇUNI

Konceptoi:
Përgj finances A.K.T B.Lolja
Drejtoria Juridike: A. Hoxha
Drejtor i A.K.T: A.Guni



3150/2

12.07.2024



2

REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA

Nr. 755/ prot.

Elbasan, më 12.7.2024


Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.66 datë 03.07.2024, "Për miratimin e tarifave për mjetet e lundrimit për zbavitje (kanoe, kayak, standpanndle) dhe për biçikletat në zyrën e Infopoint Funar", si dhe "Për miratimin e tarifave të reja për biletat e Muzeut Etnografik sipas kategorive të përcaktuara", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
AË MYSLIU



BASHKIA ELBASAN

PROJEKT DOKUMENTI

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2025 - 2027**

Qershor 2024

PËRMBAJTJA

LOGO.....	1
1. HYRJE	4
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	4
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	6
2. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË ELBASAN 2025-2027	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
2.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË ELBASAN NË VITET 2024-2026	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
2.1.2 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Elbasan për vitet 2024-2026	13
2.1.3 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Elbasan për periudhën 2024-2026.....	Error! Bookmark not defined.
3. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE.....	21
3.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	22
3.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	30
3.1.3 Projektet e Investimeve të Programit	63
3.1.4 Informacione Bazë mbi Programin	65

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë ELBASAN.....	8
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit.....	9
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.....	13
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike.....	15
